



ÇFARË BËN ZYRA E AVOKATIT TË POPULLIT?

Zyra e Avokatit të Popullit ka për detyrë të mbikëqyrë, ruajë dhe mbrojë të drejtat tuaja themelore kur ndërveproni me Dhomat e Specializuara të Kosovës (DHSK) ose Zyrën e Prokurorit të Specializuar (ZPS).

Avokati i Popullit mund:

- të marrë ankesa dhe të shqyrtojë pranueshmërinë e tyre;
- të kryejë hetime lidhur me ankesa të pranueshme;
- të hyjë dhe të kryejë inspektime në objektet e paraburgimit;
- të mundësojë ndërmjetësim dhe pajtim, kur është e përshtatshme;
- t'u paraqesë rekomandime Kryetarit të Dhomave të Specializuara dhe Prokurorit të Specializuar; dhe
- t'i bëjë referime Dhomës së Specializuar të Gjykatës Kushtetuese.



KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS
SPECIJALIZOVANA VEÇA KOSOVA

ZYRA E AVOKATIT TË POPULLIT

MBIKËQYR

MBRON

RUAN

KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS

P.O. Box 47
2501 CA The Hague
The Netherlands

www.scp-ks.org

PROCEDURA E ANKESAVE

Kush mund t'i paraqesë ankesë Avokatit të Popullit?

Avokatit të Popullit mund t'i paraqesë ankesë kushdo që ndërvepron me Dhomat e Specializuara të Kosovës, ose Zyrën e Prokurorit të Specializuar të Kosovës dhe që pretendon shkelje të të drejtave themelore të veta.

Cilat janë kriteret kryesore për paraqitjen e ankesës?

Duhet të provoni se keni ndërvepruar me Dhomat e Specializuara të Kosovës, ose Zyrën e Prokurorit të Specializuar të Kosovës. Gjithashtu, ankesa duhet të jetë në lidhje me shkeljen e pretenduar të të drejtave tuaja themelore prej Dhomave të Specializuara të Kosovës, ose Zyrës së Prokurorit të Specializuar të Kosovës.

Si mund të paraqes ankesë?

Në faqen e Internetit do ta gjeni **formularin për kontakt të mbrojtur**. Pasi të keni dorëzuar të dhënat personale përmes këtij formulari, Zyra e Avokatit të Popullit do t'ju kontaktojë dhe japë informacion të mëtejshëm në lidhje me paraqitjen e ankesës. Në rast vështirësie në hapjen ose plotësimin e formularit për kontakt të mbrojtur mund ta kontaktoni Zyrën e Avokatit të Popullit me postë të rregullt ose elektronike.

Çfarë bën Avokati i Popullit?

Avokati i Popullit e shqyrton ankesën tuaj. Në qoftë se bindet që ankesa lidhet me një shkelje të pretenduar të të drejtave tuaja themelore prej Dhomave të Specializuara të Kosovës, ose Zyrës së Prokurorit të Specializuar të Kosovës, Avokati i Popullit mund të kryejë hetim lidhur me ankesën. Pas përfundimit të hetimit, Avokati i Popullit vendos nëse është kryer, ose nuk është kryer shkelje e të drejtave tuaja themelore. Ai nxjerr raport për përfundimet e veta dhe, sipas rastit, paraqet rekomandime.

Kufizime që duhet t'i mbani parasysh

Avokati i Popullit nuk mund të ndërhyjë në çështje ose procedura të tjera ligjore para

Dhomave të Specializuara të Kosovës. Prandaj, nëse ankesa juaj ka të bëjë me ndonjë çështje ose procedurë ligjore para Dhomave të Specializuara të Kosovës, Avokati i Popullit nuk mund ta shqyrtojë ankesën, përveçse kur ajo lidhet me vonesa të paarsyeshme në ato procedura. Gjithashtu, përpara se të procedojë me ankesën tuaj, Avokati i Popullit duhet të bindet se i keni shfrytëzuar të gjitha mjetet e disponueshme juridike në lidhje me të.

Konfidencialiteti

Gjatë trajtimit të ankesës suaj, Avokati i Popullit u përmbahet standardeve më të larta të konfidencialitetit dhe garanton mbrojtjen dhe sigurinë e gjithë informacionit konfidencial që ka marrë.

Për pyetje të mediave dhe pyetje të përgjithshme ju lutemi kontaktoni Njësinë për Informim dhe Komunikim me Publikun në: MediaKSC@scp-ks.org ose me telefon në numrin **+31 (0)6 249 21036**.

Zyrën e Avokatit të Popullit mund ta kontaktoni me postë elektronike në adresën: ombudsperson@scp-ks.org, vizitoni faqen e Internetit: www.scp-ks.org ose shkruani në adresën:
OFFICE OF THE OMBUDSPERSON,
KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS,
P.O. BOX 47, 2501 CA,
THE HAGUE
THE NETHERLANDS